



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:111534

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05765670

C.nr.209/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË / DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Hatixhe Begaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.M. nga M., të cilin me autorizim e përfaqëson av.Arta Dedaj nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, të cilën e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike Kompensim i pagave përcjellëse, me vlerë të kontestit 1,716.84, jashtë seancës gjyqësore, me datë 31.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Për shkak te padegjueshmerise (mosbindjes)

- I. **APROVOHET ne teresi** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses B.M. nga M., ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, që paditëses në emër të tri pagave përcjellëse, t’ia paguaj shumën në vlerë tri pagave mujore, ne shumen prej 1,716.84 euro, me kamatë ligjore 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (datë 21.04.2022) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria për Arsim dhe Edukim, qe ne emër te shpenzimeve t’ia paguaj paditëses shumen prej 134 Euro.

A r s y e t i m

Paditësja, pranë kësaj gjykate me datën 21.04.2022, ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimin e pagave përcjellëse me rastin e pensionimit. Në padi ka deklaruar se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënëse në Gjimnazin “H. B.” , në M., dhe se me datë 25.04.2021 i është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas fuqisë së ligjit për shkak të plotësimit të kushteve për pensionin bazik të moshës. Tutje ka shtuar se në mbështetje Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të punësuarit i takon shpërblimi në tri paga mujore me rastin e pensionimit. Tutje ka shtuar se pasi qe janë konsumuar te gjitha mjetet e brendshme për realizimin e te drejtës sime ligjore, ndërsa e paditura si punëdhënëse nuk i ka përmbushur obligimit qe rrjedhin nga kontrata kolektive e dt.22.01.2021, andaj ka kërkuar nga gjykata qe te aprovohet ne tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia dhe te detyrohet e paditura, Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, që paditëses në emër të tri pagave përcjellëse, t’ia paguaj shumën në vlerë tri pagave mujore, ne shumen prej 1,716.84 euro, me kamatë ligjore 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (datë 09.08.2019) e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata, në kuptim të dispozitës nga neni 394 të LPK-së, përmes aktvendimit të dt 12.03.2024, padinë me të gjitha shkresat e bashkangjitura ia ka dërguar të paditurës, në mënyrë që t'i mundësohet paraqitja e përgjigjes në padi. Nga fletëdërgesa për dorëzim personal konstatohet se aktvendimi i lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga e paditura me dt.15.03.2024, mirëpo deri më tani Gjykatës i rezulton se e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit prej 15 ditësh, afat ky i përcaktuar me dispozitën nga neni 395 par.1 të LPK-së, duke e lëshuar në këtë mënyrë mundësinë për paraqitjen e prapësimeve të karakterit procedural apo material, gjegjësisht kontestimit të kërkesëpadisë së palës paditëse.

Në një situatë të tillë, mbi bazën e vlerësimit të pretendimeve të palës paditëse e në lidhshmëri me provat e bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se nga faktet e treguara në padi del themelësia e kërkesëpadisë, fakte këto të cilat nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga ana e paditësit. Rrjedhimisht, janë përmbushur prezumimet ligjore për aprovimin e kërkesëpadisë përmes dhënies së aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë (mosbindjes), në kuptim të dispozitës nga neni 150 par.1 të LPK-së, e cila përcakton: *“Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjigjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht.”*

Nga provat e bashkangjitura në padi, Gjykatës i rezulton se paditësja B. M. ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën, gjegjësisht ka qenë e punësuar në pozitën mësimdhënës në Gjymnazin “H.B.”, në M., deri në momentin e pensionimit. Kjo vërtetohet edhe sipas vendimit për pensionim me Nr.prot.11/410, datë 02.04.2021. Po ashtu, nga ky vendim vërtetohet se paditësit me datë 26.04.2021 i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit. si dhe po ashtu nga kontrata e punës vërtetohet se paditësi në momentin e pensionimit realizonte pagë mujore në shumën prej 572.28 Euro. Gjykata u' a fali besimin e plotë në kuptim të dispozitës nga neni 329 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“329.1 Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”*

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, sa i përket pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, Gjykata në rastin konkret vlerëson se duhet të aplikohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (në vijim si: KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021, kjo për faktin se paditësja moshën e pensionimit e ka arritur në vitin 2021, kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive në fjalë.

Çështja e kompensimit të pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, parashihet me dispozitën nga neni 35 par. 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit, e vitit 2017, në të cilën dispozitë është përcaktuar se: *“Punëtorët (Anëtarë të SBASHKU-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë*

përcjellëse në lartësi të tri pagave, sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit.”, 9.1 pagat përcjellëse paguhen nga punëdhënësi i fundit, dhe jo më larg se 30 ditë nga dita e pensionit.

Andaj, bazuar në nenin 35 par. 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit, e vitit 2021, rezulton se e paditura, me rastin e pensionimit ka për obligim që paditëses t’ia paguajë në emër të pagave përcjellëse tri paga, në vlerën e tre pagave të fundit të cilat i ka realizuar paditësja. Gjykata po ashtu gjen, se sipas provave të lartë cituara, paditësja e plotëson kushtin primar, që moshën e pensionimit ta arrijë gjatë kohës sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit, ngase paditësi moshën e pensionimit e ka arritur me datë 25.04.2021, pra gjatë kohës sa ka qenë në fuqi KKAK-ja.

Mbi këtë bazë, Gjykata vlerëson se paditësja, sa i përket pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, është legjitimuar të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrëdhënia e detyrimit mes palëve ndërgjyqëse, në kuptim të dispozitës nga neni 245 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e ti.”.

Bazuar në dispozitat dhe provat e lartë cituara, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses t’ia paguajë tri paga përcjellëse me rastin e pensionimit, në shumën prej 572.28 për një pagë, apo shumën totale prej 1,716.84€ euro në emër të pagave përcjellëse.

Lidhur me kumatën ligjore prej 8% në vit, Gjykata ka vendosur konform nenit 382 par.1 lidhur me par. 2 të LMD-së, duke e obliguar të paditurën që shumën e gjykuar në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, t’ia paguajë së bashku me kumatë ligjore prej 8% në vit, e cila kumatë do të fillojë të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë në Gjykatës, e deri në pagesën definitive të shumës si në pikën I të dispozitivit.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet shumës prej 104 euro për përpilim padie dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 31 euro.

Prandaj, mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të nenit 160 lidhur me nenin 150 par.1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË- DEGA NË MALISHEVË

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni civil

C.nr.1154/21, datë 31.05.2024.

G j y q t a r j a
Hatixhe Begaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.